Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**16.01.2024**	**09.02.2024**	**2024/0044**
Eksperti Teknik **Ernest Kërqeli**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **24.01.2024**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.01.2024, OE "SolvIT SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0044, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "N.T.SH ARTECH, TRIO TEK SH.P.K., Bionics SH.P.K"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me TABELA Digjitale per Shkolla Fillore dhe te Mesme" me nr. të prokurimit: "642-23-3891-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 140,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 23/04/2023

Hapja e tenderëve: 06/06/2023

Vendimi i AK-së: 13/11/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0044 i dt:12.01.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP Nr.04/L-042 Qellimi

Neni 7. Barazia ne trajtim / jo-diskriminimi

Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60. Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 64 Dështmitë e kërkesave

Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Pretendimi 1: Diplomat e prezantura nuk jane te noterizuara ne emrin e poseduesit te diplomes.

OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar diplomat e stafit te cilat permbajne emra dhe te dhena te tjera personale ndryshe nga poseduesi i diplomes. Ka qene e pamundur te deshmohet vertetesia e tyre pasi dokumenti i leshuar nga nje noter nuk permban as emrin as ndonje shenim tjeter te personit te cilit i perket ajo diplome!

Ne pergjigjen e GOE kane deklaruar se kane noterizuar keto diploma me autorizim, por siq shifet me poshte ne aktin noterial nuk permendet autorizimi i prsonit te trete te äutorizuar" pra nuk kane paraqitur ndonje autorizim qe verteton kete deklarate te tyre.

Pa dashur te leshohemi shume ne ate pjese se si ka ardhur deri tek ky modifikim, mendojme qe ky noterizim permban te dhena te modifikuara!. Pamundesia e vertetimit te vlefshmerise se atyre diplomave tregon qe ky OE i shpallur fitues nuk permbush kerkesat e DT. Instancat me te larta si Gjykata mund te konsideroj keto dokumente si jo reale dhe ti aplikoj masat e veta ndeshkuese. Si do qe te jete, per ne si OE Ankues eshte e mjaftueshme dhe me rendesi te trajtohet sikurse ky dokument te mos jete dorezuar fare (Mungon) nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate. Po e cekim edhe nje here, ne nuk jemi te interesuar te thellohemi ne kete qeshtje dhe ti shkaktojme deme, per ne thjesht dokument nuk eshte i rregullt! Mungon **Diploma 1 dhe diploma 2 sipas kerkesave,** ne vijim prova:

AK ne DT ka kerkuar qe **menaxheri i kontrates** edhe **menaxheri i projektit** ti kene diplomat e noterizuara.

Duke marre parasyshe qe ky ka qene kusht i FDT ne pjesen "Kerkesat mbi mbundesite teknike dhe Profesionale Pika 9.1&9.2" k**usht i cili nuk eshte plotesuar nga Grupi OE-ve te shpallur fitues**, atehere kjo oferte nga Grupi i OE-ve te shpallur fitues eshte dashur

te konsiderohej si **oferte e pa pergjegjshme** pasi qe nuk i ploteson kushtet mbi mundesite tekinke dhe/pse administrative. Dhe jo te shpallet fitues ashtu si ka vepruar AK duke shkelur Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimi 2.A: Paisja e ofruar nga OE fitues nuk permbush specifikat teknike

Duke krahasuar kerkesat ne DT dhe Broshuren e dorezuar nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate, kemi verejtur qe oferta e tyre nuk permbush keto specifikime teknike:

Specifikimi 1: Ne DT kerkohet qe paisja te kete 2 porte USB 2.0. ndersa grupi i OE-ve te shpallur fitues ka ofruar produktin me vetem 1 (nje) port USB 2.0
Kerkesa:

Porte USB 2.0 : minimum 2 USB

Oferta:
Kurse, GOE ka ofruar produktin qe ka vetem **1 port USB 2.0**! Broshuren e dorezuar nga GOE e gjeni me poshte:

EARPHONE OUTPUT	1
COAX IN	1
HDMI 2.0 INPUT	2
RS232	1
USB 3.0	1
USB 2.0	1
Blue tooth	1
WI-FI	1*2.4G,
Windows OPS Slot	OPS & OPS-C I
VGA INPUT	1
PC AUDIO INPUT	1

Pra duke pare qe ky kusht nuk eshte plotesuar nga ky grup i OE-ve, eshte dashur qe kjo oferte te shpallet e pa pegjegjshme teknikisht.
Specifikimi 2: Ne DT kerkohet qe paisja te kete 2 (dy) porte USB 3.0. Ndersa Grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate ka ofruar produkte me vetem 1 (nje) port USB 2.0. Kete mund ta shihni me poshte:

Porte USB 3.0 : minimum 2 USB

Ndersa me poshtue Ofruar nga Grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate: (shkeputje nga broshura e ofruar)

USB 3.0	1
USB 2.0	1
Blue tooth	1
WI-FI	1*2.4G,
Windows OPS Slot	OPS & OPS-C I
VGA INPUT	1
PC AUDIO INPUT	1

Pra ktu kemi nje diskrepance te kjarte dhe te matur objektivisht, qe nr 1 dhe 2 jane ndryshe nga njeri tjetri. Pra jane kerkuar 2 porte te shpejtesise 3.0 ndersa eshte ofruar produkt me vetem 1 (nje) port te shpejtesise 3.0

Specifikimi 3: Ne DT kerkohet qe paisja te kete 1 port Coax Out. Kete mund ta shihni me poshte:

AV Out 1 dhe Coax Out 1

Ne oferten e grupit te OE-ve te shpallur fitues te ketij projekti, nuk shifet askund te jete ofruar produkt me Coax Out. Prandaj edhe per kete specifikim teknik oferta e grupit te OE-ve te rekomanduar per kontrate eshte dashur te konsiderohet si e pa pergjegjshme teknikisht.

Pretendimi 2.B TENTIMI I AK dhe OE per ndryshimin e specifikave pas dorezimit te tenderit

Ne kemi ngritur kete qeshtje ne kerkesen tone per Rishqyrtim prane AK, dhe ne pergjigjen qe kemi pranuar, ky GOE ka tentuar te arsyetohet kinse ka nje konfirmim nga prodhuesi qe keto paisje do ti kene keto specifika, qe i bie qe eshte nje paisje tjeter, apo modifikim i specifikimeve teknike pas skadimit te afatit te dorezimit te tendereve. Per ne eshte e paqarte se si ky GOE ka dorezuar fotografi amatore qe duket te jete e nje paisje tjeter dhe

nuk i perkasin broshures se dorezuar para skadimit te afatit te dorezimit te tendereve, pasi ky produkt qe ka ofruar shihet qarte qe nuk i ploteson kerkesat specifike qe gjenden ne DT. Tash, kur ky produkt eshte ndryshe nga ai qe ka ofertuar, atehere kjo ven ne pikepyetje edhe specifikat tjera qe mund te mos i plotesoje.Pra, ne te dyja rastet ky GOE do duhej te vleresohej si i papergjegjshem.

Kjo oferte me mungese te 3 specifikave te mangeta eshte dashur qe te refuzohet atomatikisht si teknikisht e pa pergjegjshme nga AK, dhe jo te shpallet fitues. Pra AK ka shkelur me dy kembet Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe keqperdor dhe shkele Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë te LPP-se ne RKS Neni 72 kjarte mundeson sigurimin e informacionit dhe ASNJEHERE modifikimin e specifikmeve teknike. Gjithashtu sipas FDT pika 4.1 "Variantet nuk autorizohen" Prandaj eshte dashur qe oferta te shpallet e pa pergjegjshme automatikisht.

Pretendimi 3: Specifikat teknike te permbushura me deklarata nga GOE por jo te konfirmuara nga prodhuesi

Pika 3.1 Ne DT kerkohet qe paisja te kete garancion minimum 2 vite, kurse ne broshuren apo katallogun e dorezuar nga OE nuk konfirmohet nga prodhuesi kjo pike e rendesishme e kerkesave teknike. Garancioni duhet te jete nga prodhuesi i pajisjes sepse prodhuesi garanton per pajisjen e tyre.

Pika 3.2 Gjithashtu, ne DT kerkohet qe paisja te kete gjuhen e programit ne Shqip dhe Anglisht, kurse ne broshure apo katallog kjo pike nuk gjendet askund, qe do te thote kjo kerkese teknike nuk plotesohet. Tutje, kjo eshte pjese qe mbulohet nga prodhuesi sepse vetem prodhuesi vendos se cfar gjuhe mund ti vej programit per funksionimin e pajisjes.

Pika 3.3 Leshimi tjeter qe eshte tentuar te mbulohet me nje deklarate nga OE eshte se a ka serial kod programi i kesaj paisje, kerkese qe gjendet ne DT. Edhe kjo pike NUK eshte pjese e specifikimeve te knike te ofruara nga OE i shpallur fitues.

Shif me poshte ku keto specifika te prodhuesit vetem konfirmohen nga vete OE dhe jo nga prodhuesi. Vertetesia e ketyre pohimeve nuk mund te konfirmohet vetem me deklarate "thash, po them, po deklaroj, po bej be" por duhet te deshmohet me dokumente nga prodhuesi.

Data: 11.10.2023

Drejtuar: KUVENDI KOMUNAL MITROVICË
Titulli:"Furnizim me TABELA Digjitale për Shkolla Fillore dhe te Mesme"
Numri i Prokurimit: 642-23-3891-1-1-1
Bazuar ne kërkesën tuaj per sqarime te tenderit ju konfirmojmë si me poshtë,

Pas analizes se ofertave dhe ofertes së juaj nga Komisioni i vlersësimit të ofertave dhe pasi oferta juaj është me qmimin më të ulët dhe i plotësoni te gjitha kriteret e tjera te DT dhe Njoftimit për Kontratë është vërejtur se në ofertën e juaj kemi hasur ë një mangësi dhe paqartsi të ofertës së juaj dhe kërkojm si në vijim:

1.Te kërkesa – Një sqarim në lidhje me kërkesen sipas kriterve te Specifikimet teknike te tabelave Digjitale për kkesen si vijon:

Kërkesa	Sqarimi
Gjuha e programit : Shqip dhe Anglisht	Po programi posedon gjuhen Shqipe dhe Anglisht
Programi duhet të përmbaj veglat e punës për secilën lëndë mësimore : Matematikë, Fizikë, Kimi etj / të gjitha në Gjuhën Shqipe	Po programi përmban veglat e punës te kërkuara Matematikë, Fizikë, Kimi etj / të gjitha në Gjuhën Shqipe Anglisht
Programi duhet të jetë me serial kod	Po programi e ka serial kodin e vete
Trajnimi i zyrtarëve të IT-së për përdorim të tabelave digjitale (50 orë)	Po ju deklarojm edhe njëher se Tranimi i zyrtarëve të IT-së për përdoim të tabelave digjitale është (50 orë)
Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar	Bashkangjitur gjeni përsëri Autorizimin e Prodhusit
Në çmim përfshihet Montimi i Paisjes	Po në çmim përfshihet Montimi i Paisjes

Faliminderit.

ARTECH NTSH
Prishtinë
10.10.2023

N. T. SH. "ARTECH" PRISHTINË

Ne kete pike duhet ceke se me Ligjet e Prokurimit ne RKS nuk pranojne verzione te ofertes, pranohet vetem 1 verzion, prandaj shtimi i specifikimeve teknike pas afatit te dorezimit te tenderve eshte i pa pranueshem dhe ne kundershitm me piken 3 te Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i cili thote se " *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive"*

Pretendimi 4: Mungon vendimi per caktimin e menaxherit te kontrates

Ne DT kerkohet emerimi i menaxherit te kontrates me vendim te OE. E ky dokument nuk eshte dorezuar nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate.
Vendimet jane kerkesa adminitrative te rendesishme konform neneve te LPP-se dhe mos perfshirja e tyre deshmon se OE nuk ka plotesuar kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe profesionale, andaj oferta e OE-ve te rekomanduar per kontrate duhet konsidaruar

Ne pergjigjen e tyre rreth kesaj pike, ky GOE ka tentuar te perziej **Vendimin per Menaxher te Projektit** me ate te **Vendimin per Menaxher te Kontrates**. Eshte e vertete qe eshte dorezuar Vendimi per Menaxher te Projektit, por jo Vendimi per Menaxher te KONTRATES. Ne DT jane kerkyar dy vendime/Emrime! Shif me poshte FDT.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në realizimin e furnizimeve, a) së paku dy persona të certifikuar për instalimin	Lista e stafit – Origjinal, për të gjitha kërkesat e stafit duhet të ofrohen dëshmi për menaxherin e kontratës (vendimin), Çertifikatën për instalimin dhe kalibrimin e Tabela Digjitale (TD) për stafin teknik

B15 Dosja e Tenderit – Furnizim- Procedur e Hapur 15

Numri i Prokurimit: 642-23-3891-1-1-1 Numri i Brendshëm: 642/23/084/111–Titulli: Furnizim me TABELA Digjitale për Shkolla Fillore dhe te Mesme

		dhe kalibrimin e Tabela Digjitale (TD), b) së paku një person të Teknologjisë Informative	nga prodhuesi apo distributori, Kopjen e diplomës universitare të noterizuar për TIK ose të Fakultetit të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike .
		OE duhet të emëroj menaxherin e projektit.	OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, me së paku tri vite përvojë, pune e dëshmuar me CV, diplomën universitare, i certifikuar me ISO 9001 Lead Implementer

Pretendimi 5: Mungon stafi i certifikuar nga prodhuesi

Ne DT kerkohet qe te dorezohen deshmi qe OE te kete ne staf teknik se paku 2 persona te certifikuar nga prodhuesi per instalimin dhe kalibrimin e tabelave. (Kerkese nga pika 9.1&9.2 kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale) e qe GOE ka dorezuar certifikaten e nje personi qe nuk ka arritur ta vertetoje qe eshte pjese e stafit permes kontrates/para kontrates. Thjeshte eshte munduar qe ta paraqese kete person si pjese te stafit permes nje liste qe e ka krijuar vete.

Gjithashtu, ne DT eshte kerkuar lista e stafit (origjinale), OE nuk ka dorezuar nje liste te tille, por ka dorezuar nje liste te thjeshte qe ka krijuar vete, e qe me ate liste eshte e pamundur te verifikohet se a eshte reale ajo liste pasi nuk ka asnje deshmi. P.sh nje liste origjinale do te konsiderohej lista e stafit e paraqitur ne ATK apo kontratave me keta persona ne liste.

Pretendimi 6: Mungon plani dinamik

Ne DT kerkohet te dorezohet plani dinamik, me deklarate nga OE rreth ketij plani dinamik maksimum 90 dite. Edhe ky dokument nuk eshte dorezuar nga OE.
Njejt edhe ne kete pike, grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate kane deshmuar se oferta e tyre nuk eshte e pergjegjshme dhe duhet konsideruar si e pa pergjeshme edhe nga AK. Ne sqarimin e GOE kane deklaruar se eshte dorezuar nje dokument i tille, por ne nuk e kemi gjetur as ne oferten e tyre pasi na eshte aprovuar kerkesa per qasje ne dokumentet qe kane dorezuar, e nuk gjindet as ne dokumentet qe kane dorezuar permes sqarimit.

Pretendimi 8: Mungon CV e menaxherit te projektit

Ne DT eshte kerkuar qe menaxheri i projektit te kete se paku 3 vite pervoje pune te deshmuar me CV, dokument te cilin GOE gjithashtu nuk e ka dorezuar.

Edhe me kete pike GOE te rekomanduar per kontrate kane deshmuar kjarte se nuk i plotesojne kushtet dhe mundesite profesionale.

Ne pergjigjet e pranuara permes kerkeses per rishqyrtim, ky GOE ka deklaruar qe CV do te dorezohet ne keto sqarime, por nuk gjendet askund. Per te vertetuar kete mund te shihni dokumentin e bashkangjitur me kete ankese (Vendimi ne kerkesen per rishqyrtim).

Pretendimi 9: Deklaratat tatimore vjetore jo te plota

Ne DT eshte kerkuar qe te dorezohen deklaratat tatimore vjetore per 3 vitet e fundit, respektivisht per vitet 2020, 2021 dhe 2022, ndersa GOE ka dorezuar vetem deklaratat tatimore per vitet 2021 dhe 2022 ku mungon edhe viti 2020. Edhe kete kerkese ky GOE ka deshtuar ta plotesoje si edhe shume te tjera, dhe quditerisht eshte rekomanduar per kontrate.

Pretendimi 10: Kontratat e perfunduara dhe referencat gjithmone ne pjesmarrje si grup.

-Shumica e kontratave dhe referencave te prezantuara nga secili anetar i ketij grupi jane kontrata ku kane qene vetem si pjesmarres ne ato kontrata te mehershme. Pra nuk kane qene ekzekutor te 100% te atyre kontratave. Pra ne si OE nuk e dime se me cfare vlere ose cfare % apo cfare peshe duhet trajtu keto kontrata te mehershme por e dime qe nuk jane 100% te anetarit pjesmarres ne kete aktivitet.
-Shumica e kontratave jane te vitit 2019, dhe duke marre parasyshe piken 1 eshte e veshtire te konkludohet se sa % e kane plotesuar kete kusht GOE te rekomanduar per kontrate.

Duke marre parasyshe se kontratat nuk jane 100% te ekzekutuara nga OE-te dhe shumica e tyre jane me te vjetra se 3 vite, atehere konkludojme se ky kusht nuk eshte plotesisht i arritur nga GOE te rekomanduar per kontrate. Gjithashtu, edhe per kete pike kemi pranuar pergjigje nga GOE, ku kinse per transparence, ka dorezuar edhe disa referenca duke u munduar qe ta plotesoje numrin, por besojme dhe shpresojme qe ky GOE e din qe keto dokumente eshte dashur te dorezohen bashke me dokukmentet tjera kur ka dorezuar kete tender.

Pretendimi 11 - Njeri nga antaret e OE-ve te shpallur fitues tanime eshte ne listen e zeze.

Eshte per tu çuditur guximi i AK se si shpall fitues nje grup te OE-ve brenda te cilit nje antar i grupit gjendet ne listen e zeze.

9	Furnizim me pajisje te IT-së	Dogana e Kosovës	Trio Tek shpk	28/07/2023	28/01/2024

Konkludim:

Kjo ankese vjen si pasoje e neglizhences nga AK ndaj neve, duke mos shqyrtuar vete kerkesat tona per rishqyrtim, por ate detyre e ka kaluar te GOE i rekomanduar per kontrate qe permes pergjigjeve te tyre boshe e shpeshhere te pakuptimta, ajo kerkese e jona te vleresohet si e pabazuar nga ana e AK-se.
Per ne eshte e pakuptimte se si ne pergjigjen e AK per kerkesen per rishqyrtim nuk jane vleresimet e eksperteve te saj, por jane disa deklarata te pabaza nga GOE, duke na derguar disa fotografi amatore te nje paisje qe nuk e dijme as llojin e as modelin e saj dhe eshte e pamundur te vertetohet ndonje gje nga ato fotografi.

Ju faleminderit!

Pretendimi 7: Mungon certifikata e ISO 9001 Lead Implementer

Ne DT eshte kerkuar qe menaxheri i projektit te jete i certifikuar me ISO 9001 Lead Implementer. Certifikate te cilen GOE nuk e ka dorezuar, e ne vend te saj ka dorezuar nje deshmi qe nje person e ka kryer nje kurs nga nje organizate e cila as nuk eshte nje trupe certifikuese per te deshmuar IMPLEMENTIMIN dhe CERTIFIKIMIN me ISO standardeve, por vetem tregon se eshte ndjekur nje kurs online 4 oresh.

Cka eshte Udemy? Te dhenat nga interneti tregojne se:
"Udemy është një platformë e mësimit në internet e bazuar në video, e cila ofron një gamë të gjerë të kurseve të ndryshme të mësimit në një gamë të gjerë të temave. Platforma është e hapur për të gjithë, dhe ju mund të gjeni kurse në disa fusha të ndryshme, përfshirë programim, projektim grafik, gjuhë të huaja, zhvillim personal, financat personale, marketingun, dhe shumë tematika të tjera"

Ne kemi bere verifikimin se a eshte UDEMY Trupe Certifikuese per kete certifikate, dhe kemi vertetuar qe kjo kompani nuk eshte ne listen e Trupave Certifikuese. Kete mund te shihni me poshte verifikimin e bere ne faqen zyrtare te INTERNATIONAL ACCREDITATION FORUM :



Ketu pra shihet qarte qe nuk ka Trupe Certifikuese me emrin UDEMY.

Gjithashtu, ne pergjigjen qe kemi pranuar nga AK rreth kerkeses tone per rishqyrtim, ky GOE na e ka derguar numrin e certifikates, e qe aj numer del te mos jete VALID.
Shif me poshte (ose ne fund te kesaj ankese):
http://www.nptmanagementsystems.co.uk/certification/iso-certification-checker



Ketu mund te shihni qe ai numer i certifikates nuk eshte valid. Pra shkelje e kjarte Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. jo vetem shkelje por mosperfillje totale

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Projektet e realizuara (të natyrës së ngjajshme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 100,000.00 euro. Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit	**Një listë e që specifikon secilin nga projektet punuese për punë te ngjashme te O.E.në 3 vitet e fundit të përcjellura me çertifikata te ekzekutimit te mire të që tregojnë vlerën,datën, llojin dhe vendin e projektit punues dhe ose aktiviteteteve të furnizimit qertifiksata e pranimit te furnizimeve. Kontratat e sektorit privat duhet te jene te shoqruara me referenca dhe deshmi te faturimit .**
Katalogje nga prodhuesi	**Katalogjet për artikuj të ofertuar,**
Prodhuesi duhet të jetë i licencuar me standardet si në vijim ISO 14001,ISO 45001,ISO 9001,CE, RoHs,	**Çertifikatat nga prodhuesi me validitet .**
Plani Dinamik	**Deklarata me shkrim nga O.E. për planin dinamik maksimum 90 ditë.**
Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në realizimin e furnizimeve, **a) së paku dy persona të certifikuar për instalimin**	**Lista e stafit – Origjinal, për të gjitha kërkesat e stafit duhet të ofrohen dëshmi për menaxherin e kontratës (vendimin),** **Çertifikatën për instalimin dhe kalibrimin e Tabela Digjitale (TD) për stafin teknik**

dhe kalibrimin e Tabela Digjitale (TD), b) së paku një person të Teknologjisë Informative	nga prodhuesi apo distributori, Kopjen e diplomës universitare të noterizuar për TIK ose të Fakultetit të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike .
OE duhet të emëroj menaxherin e projektit.	OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, me së paku tri vite përvojë, pune e dëshmuar me CV, diplomën universitare, i certifikuar me ISO 9001 Lead Implementer
Trajnim i zyrtarëve të IT-së për përdorim të TD	OE obligohet të bëjë Trajnimin e zyrtarëve të IT-së për përdorimin e Tabela Digjitale (TD)

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opstina Mitrovica - Municipality of Mitrovica

Zyra e Prokurimit / Kancelarije Nabavke / Office of Procurement

DATË/A:	03.01.2024
REFERENCË:	642/23/3891/084/121
PËR/ZA/TO:	SolvIT SH.P.K.
CC:	Bedri HAMZA -Kryetar i Komunës se Mitrovicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	E-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Kosovare HAJDINI OSMANI – UD ZPP-Zyra e Prokurimit – Komuna e Mitrovicës
SUBJKETI/SUBJEKTA/ SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit "Furnizim me TABELA Digjitale per Shkolla Fillore dhe te Mesme"

Komuna e Mitrovicës, duke vendosur sipas Kërkesës per Rishqyrtim te Tenderuesit, SolvIT SH.P.K., të datës 20.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me TABELA Digjitale per Shkolla Fillore dhe te Mesme", me numër te prokurimit: 642-23-3891-1-2-1, numri i brendshëm 642/23/084/121, kundër B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK te publikuar me datën 24.10.2023 ne platformën elektronike, AK mbështetur ne Ligjin Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikës se Kosoves, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP), nxjerr këtë:

VENDIM

I. REFUZOHET si e PA BAZUAR KERKESA PER RISHQYRTIM e parashtruar nga OE SolvIT SH.P.K., SI PJESERISHT E BAZUAR lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me TABELA Digjitale per Shkolla Fillore dhe te Mesme", me numër te prokurimit: 642-23-3891-1-2-1 , numri i brendshëm 642/23/084/121, kundër B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK te publikuar me datën 24.10.2023.

PRETENDIMET ANKIMORE

Tenderuesi SolvIT SH.P.K., si palë e pakënaqur ka parashtruar Kërkesë per Rishqyrtim Tek AK me datën 20.11.2023 kundër B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK te publikuar me datën 24.10.2023 ne platformën elektronike per tenderin: "Furnizim me TABELA Digjitale per Shkolla Fillore dhe te Mesme", me numër te prokurimit: 642-23-3891-1-2-1, numri i brendshëm 642/23/084/121.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **SolvIT SH.P.K.**

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që**:** **"***Diplomat e prezantura nuk jane te noterizuara ne emrin e poseduesit te diplomes. OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar diplomat e stafit te cilat permbajne emra dhe te dhena te tjera personale ndryshe nga poseduesi i diplomes. Ka qene e pamundur te deshmohet vertetesia e tyre pasi dokumenti i leshuar nga nje noter nuk permban as emrin as ndonje shenim tjeter te personit te cilit i perket ajo diplome! Ne pergjigjen e GOE kane deklaruar se kane noterizuar keto diploma me autorizim, por siq shifet me poshte ne aktin noterial nuk permendet autorizimi i prsonit te trete te äutorizuar" pra nuk kane paraqitur ndonje autorizim qe verteton kete deklarate te tyre."*

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në Dosje të Tenderit ka kërkuar që diplomat për stafin e angazhuar në këtë aktivitet të prokurimit duhet të jenë të noterizuara. Sipas OE ankues, OE i rekomanduar në ofertë ka dorëzuar dy diploma për stafin i cili do të angazhohet, të noterizuara nga një palë e tretë. Eksperti pasqyron se këto diploma është e vërtetë që nuk janë të noterizuara nga personat gjegjës të cilëve ju takon kjo diplomë, megjithatë vula e noterit e vendosur në kopje të diplomës, është identike me vulën e noterit të vendosur edhe në Dëshminë e dokumentit të vërtetuar nga ana e noterit. Pra, kjo pjesë e noterizimit tregon që dokumenti kopje është identik me dokumentin origjinal të dorëzuar dhe vula e njëjtë e kësaj pjese gjendet edhe në kopjen e diplomës, sipas ekspertit kjo është ajo çfarë ka më së shumti rëndësi që diploma kopje e noterizuar të jetë e njëjtë me origjinalin e diplomës. Po ashtu, AK përmes DT-së nuk ka kërkuar që diplomat e stafit duhet të jenë të noterizuara nga vet personi të cilit i takon ajo diplomë. Edhe pse këto diploma janë noterizuar nga një person i tretë, noteri pranon se kopja është identike me diplomën në origjinal (e vërtetuar me vulën e njëjtë të noterit), andaj nuk shihet se në këtë aspekt mund të ketë ndonjë dyshim se këto diploma nuk janë sipas kërkesave të DT-së. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 2

"Paisja e ofruar nga OE fitues nuk permbush specifikat teknike. Duke krahasuar kerkesat ne DT dhe Broshuren e dorezuar nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate, kemi verejtur

qe oferta e tyre nuk permbush keto specifikime teknike: Specifikimi 1: Ne DT kerkohet qe paisja te kete 2 porte USB 2.0. ndersa grupi i OE-ve te shpallur fitues ka ofruar produktin me vetem 1 (nje) port USB 2.0.

Po ashtu ne DT kerkohet qe paisja te kete 2 (dy) porte USB 3.0. Ndersa Grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate ka ofruar produkte me vetem 1 (nje) port USB 2.0.

Gjithashtu ne DT kerkohet qe paisja te kete 1 port Coax Out. Ne oferten e grupit te OE-ve te shpallur fitues te ketij projekti, nuk shifet askund te jete ofruar produkt me Coax Out. Prandaj edhe per kete specifikim teknik oferta e grupit te OE-ve te rekomanduar per kontrate eshte dashur te konsiderohet si e pa pergjegjshme teknikisht."

Sipas ekspertit teknik, pretendimi ankimor i OE ankues, SolvIT shpk, kundrejt vendimit te AK lidhur me mos plotesimin e specifikimeve teknike nga ana e OE te rekomanduar per kontrate, ka te beje me mos plotesimin e kërkesave teknike konform DT-së, gjegjësisht, ANEKS1 kërkon që pajisja e ofertuar të ketë dy (2) USB 2.0 porte, dy (2) USB 3.0 porte dhe CoaxOUT një(1) port. Pas administrimit të dokumentacionit të prezantuar në ofertën e OE të rekomanduar, duke përfshirë katalogun e pajisjes së ofertuar dhe sqarimet shtesë nga ana e OE, mund të konstatohet se pajisja e ofertuar nuk përmbush kërkesat mbi specifikimet teknike të DT, OE i rekomanduar ka ofertuar një pajisje që ka vetëm një port USB 2.0, ndryshe nga kërkesa për dy (2) porta të tilla. Pajisja e ofertuar gjithashtu nuk përmbush kërkesat për specifikimet teknike lidhur me numrin e porteve USB 3.0, ku është kërkuar që të jenë dy (2) porte USB 3.0, ndërsa në pajisjen e ofertuar komfor katalogut ka vetëm një (1) port të tillë. Lidhur me pretendimin për portin CoaxOUT, në DT është kërkuar që pajisja të ketë një (1) port të tillë, ndërsa pajisja e ofertuar nga OE i rekomanduar nuk e posedon fare. Në letër për sqarime shtesë, komisioni i vlerësimit ka vënë re këtë ndryshim. Prandaj, Komisioni i vlerësimit bën ekzaminimin e pajisjes duke u bazuar në dokumentet e prezentuara sipas DT në 9.1 dhe 9.2, duke kërkuar katalog për pajisjet e ofertuara. Edhe përkundër zotimit të OE-së rekomanduar që pajisja do të prodhohet sipas kërkesave të DT (pas kërkesës për sqarime shtesë), është në diskrecionin e AK zbatimi i Nenit 59 të LPP, si do të jetë siç është shpjeguar më lart, lidhur me pretendimin e OE ankues eksperti teknik konsideron se pretendimi është i bazuar**.**

Pretendimi 3

"*TENTIMI I AK dhe OE per ndryshimin e specifikave pas dorezimit te tenderit Ne kemi ngritur kete qeshtje ne kerkesen tone per Rishqyrtim prane AK, dhe ne pergjigjen qe kemi pranuar, ky GOE ka tentuar te arsyetohet kinse ka nje konfirmim nga prodhuesi qe keto paisje do ti kene keto specifika, qe i bie qe eshte nje paisje tjeter, apo modifikim i specifikimeve teknike pas skadimit te afatit te dorezimit te tendereve. Per ne eshte e paqarte se si ky GOE ka dorezuar fotografi amatore qe duket te jete e nje paisje tjeter dhe nuk i perkasin broshures se dorezuar para skadimit te afatit te dorezimit te tendereve, pasi ky produkt qe ka ofruar shihet qarte qe nuk i ploteson kerkesat specifike qe gjenden ne DT. Tash, kur ky produkt eshte ndryshe nga ai qe ka ofertuar, atehere kjo ven ne pikepyetje edhe specifikat tjera qe mund te mos i plotesoje.Pra, ne te dyja rastet ky GOE do duhej te vleresohej si i papergjegjshem."*

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, sa i përket kësaj pike, eksperti teknik sqaron se shihet se ka mos përputhje mes ofertës/katalogut të pajisjes së ofruar dhe fotografive të dorëzuara, pra produkti është ndryshe nga pajisja e ofruar. Prandaj, pretendimi ankimor është i

bazuar.

Pretendimi 4

"*Pika 3.1 Ne DT kerkohet qe paisja te kete garancion minimum 2 vite, kurse ne broshuren apo katallogun e dorezuar nga OE nuk konfirmohet nga prodhuesi kjo pike e rendesishme e kerkesave teknike. Garancioni duhet te jete nga prodhuesi i pajisjes sepse prodhuesi garanton per pajisjen e tyre. Pika 3.2 Gjithashtu, ne DT kerkohet qe paisja te kete gjuhen e programit ne Shqip dhe Anglisht, kurse ne broshure apo katallog kjo pike nuk gjendet askund, qe do te thote kjo kerkese teknike nuk plotesohet. Tutje, kjo eshte pjese qe mbulohet nga prodhuesi sepse vetem prodhuesi vendos se cfar gjuhe mund ti vej programit per funksionimin e pajisjes. Pika 3.3 Leshimi tjeter qe eshte tentuar te mbulohet me nje deklarate nga OE eshte se a ka serial kod programi i kesaj paisje, kerkese qe gjendet ne DT. Edhe kjo pike NUK eshte pjese e specifikimeve teknike te ofruara nga OE i shpallur fitues.*"

Eksperti shqyrtues sqaron se në ofertë, OE ankues ka dorëzuar Deklaratën për garancionin e pajisjeve me kohëzgjatje 2 vjeçare, ashtu siç është kërkuar në specifikacionin teknik. Kjo deklaratë sipas ekspertit i përmbushë kërkesat për garancionin e pajisjeve. Në DT nuk ka pasur asnjë kriter që garancioni duhet të jetë nga prodhuesi, andaj për kërkesa që nuk janë të parapara në DT apo në specifikacione teknik, nuk mund të kërkohen kritere shtesë nga operatorët ekonomik.

Sipas ekspertit teknik, lidhur me pretendimin ankimor 3, ku OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesat teknike të kërkuara në ANEKS 1 të DT, siç është fjala për garancionin e prezantuar, gjuhën e programit dhe Kodin Serial. Eksperti teknik, pas administrimit të dokumentacionit, thekson se në katalogun e prezantuar nga OE i rekomanduar mungojnë këto të dhëna. Meqenëse AK ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me të dhënat që nuk janë në katalogun e prezantuar, në mënyrë që të sqarohen dhe të bëhet vlerësimi i ofertës, shihet se OE në përgjigjen e tyre ka pohuar se ky produkt posedon gjuhën shqipe dhe angleze, posedon Kodin Serial dhe ofron garancion dy (2) vite për produktin e prezantuar, ashtu si është cekur në deklaratën e prezentuar, të vulosur dhe nënshkruar. Prandaj, bazuar në sqarimet e dhëna më sipër, vlerësojmë se pretendimi i OE ankues kundrejt vendimit të AK në këtë çështje është i pa bazuar.

Pretendimi 5

"Mungon vendimi per caktimin e menaxherit te kontrates Ne DT kerkohet emerimi i menaxherit te kontrates me vendim te OE. E ky dokument nuk eshte dorezuar nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate. Vendimet jane kerkesa adminitrative te rendesishme konform neneve te LPP-se dhe mos perfshirja e tyre deshmon se OE nuk ka plotesuar kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe profesionale, andaj oferta e OE-ve te rekomanduar per kontrate duhet konsidaruar automatikisht si e pa përgjegjshme."

Eksperti sqaron se në DT në asnjë pikë të saj nuk është kërkuar që operatorët pjesëmarrës duhet të emërojnë dy persona të ndryshëm në dy pozita të ndryshme siç është menaxher i projektit dhe një menaxher kontrate. Është e vërtetë që në DT janë përdorur dy terme të ndryshme që sipas ekspertit janë duke aloduar në personin e njëjtë. Pra, tek pjesa e stafit është kërkuar që të ofrohet vendimi për menaxherin e kontratës dhe tek pika tjetër janë treguar kushtet që duhet përmbushur nga stafi për të qenë i emëruar si menaxher projekti. Sipas

ekspertit në këtë pikë, në të dyja rastet shihet se fjala ka qenë për personin e njëjtë (menaxherin e projektit), mirëpo për të cilin janë përdorur dy terme të ndryshme, të njëjtën gjë e thotë edhe AK në shqyrtimin e kërkesës për rishyqrtim, duke e cekur se ky dokument është dorëzuar në ofertë, përkatësisht në listën e dokumenteve të dorëzuara nr.9- Emri i dokumnetit: Deklaratat Garancioni Afatet.pdf, ku gjendet vendimi i emërimit të menaxherit të projektit. Andaj, edhe ky fakt lë për të nënkuptuar se AK në dosje ka folur për të njëjtin person edhe pse janë përdorur dy terme të ndryshme. Në ofertën e OE i rekomanduar edhe eksperti sqaron se gjendet vendimi i emërimit të menaxherit të projektit sipas kërkesave të DT-së, andaj konsiderojmë që ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 6

"Mungon stafi i certifikuar nga prodhuesi Ne DT kerkohet qe te dorezohen deshmi qe OE te kete ne staf teknik se paku 2 persona te certifikuar nga prodhuesi per instalimin dhe kalibrimin e tabelave. GOE ka dorezuar certifikaten e nje personi qe nuk ka arritur ta vertetoje qe eshte pjese e stafit permes kontrates/para kontrates. Thjeshte eshte munduar qe ta paraqese kete person si pjese te stafit permes nje liste qe e ka krijuar vete. Gjithashtu, ne DT eshte kerkuar lista e stafit (origjinale), OE nuk ka dorezuar nje liste te tille, por ka dorezuar nje liste te thjeshte qe ka krijuar vete, e qe me ate liste eshte e pamundur te verifikohet se a eshte reale ajo liste pasi nuk ka asnje deshmi. P.sh nje liste origjinale do te konsiderohej lista e stafit e paraqitur ne ATK apo kontratave me keta persona ne liste."

Sa i përket listës së stafit, OE i rekomanduar ka dorëzuar listën me stafin i cili është i paraparë që të angazhohet në këtë aktivitete të prokurimit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kjo listë përmbanë emrat e të gjithë stafit dhe gjithashtu është origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori pjesëmarrës. Lista e punonjësve të paraqitur në ATK nuk ka qenë kërkesë e DT-së, andaj për çdo kriter i cili nuk është i përfshirë në DT, sipas nenit 52 të LPP-së nuk mund të shtohen kërkesa të tjera që nuk janë paraparë më herët.

Për pikën tjetër të certifikimit të stafit nga prodhuesi, eksperti sqaron se sipas kërkesave të DT-së, për dy nga stafi i përfshirë në listë janë dorëzuar certifikatat nga prodhuesi se këta individ janë të certifikuar për instalim dhe kalibrim të tabelës digjitale (dokumenti i 7-të i ofertës së OE i rekomanduar). Andaj edhe në këtë pikë sipas ekspertit është plotësuar kërkesa e DT-së dhe pretendimi i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 7

"Mungon plani dinamik Ne DT kerkohet te dorezohet plani dinamik, me deklarate nga OE rreth ketij plani dinamik maksimum 90 dite. Edhe ky dokument nuk eshte dorezuar nga OE. Njejt edhe ne kete pike, grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate kane deshmuar se oferta e tyre nuk eshte e pergjegjshme dhe duhet konsideruar si e pa pergjeshme edhe nga AK. Ne sqarimin e GOE kane deklaruar se eshte dorezuar nje dokument i tille, por ne nuk e kemi gjetur as ne oferten e tyre pasi na eshte aprovuar kerkesa per qasje ne dokumentet qe kane dorezuar, e nuk gjindet as ne dokumentet qe kane dorezuar permes sqarimit."

Eksperti shqyrtues sqaron se përmes DT-së, Ak ka kërkuar që operatorët pjesëmarrës të dorëzojnë edhe planin dinamik, ku si dëshmi duhet të ofrojnë deklaratë me shkrim për planin dinamik, maksimum 90 ditë. Në ofertën e OE i rekomanduar, është bashkëngjitur edhe deklarata e planit dinamik, ku operatori pranon se se afati i liferimit dhe Implementimit të

projektit për të gjitha paisjet e ofruara është 90 ditë nga data e marrjes se urdhërblerjes. Sipas ekspertit një deklaratë e tillë plotëson kriteret e DT-së, sepse kriteri ka qenë që OE të ofrojnë deklaratë dhe jo një plan të detajuar dinamik me të gjitha aktivitetet e realizimit siç po aludohet nga ana e OE ankues. Prandaj, ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 8

"Ne DT eshte kerkuar qe menaxheri i projektit te kete se paku 3 vite pervoje pune te deshmuar me CV, dokument te cilin GOE gjithashtu nuk e ka dorezuar. Edhe me kete pike GOE te rekomanduar per kontrate kane deshmuar kjarte se nuk i plotesojne kushtet dhe mundesite profesionale. Ne pergjigjet e pranuara permes kerkeses per rishqyrtim, ky GOE ka deklaruar qe CV do te dorezohet ne keto sqarime, por nuk gjendet askund. Per te vertetuar kete mund te shihni dokumentin e bashkangjitur me kete ankese (Vendimi ne kerkesen per rishqyrtim)."

Sipas DT-së, OE duhet të emërojnë Menaxherin e Projektit i cili ka tre vite përvojë pune dhe kjo të dëshmohet përmes CV-së. OE i rekomanduar me ofertë, ka dorëzuar diplomën për menaxherin e projektit, por jo edhe CV-në. CV nga ana e OE i rekomanduar është kërkuar përmes sqarimeve shtesë. Sipas ekspertit, dokumenti i CV-së është shumë vështirë të dëshmohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar edhe para hapjes së ofertave, si i tillë ky dokument mund të përbëjë plotësim të ofertës, e cila bie ndesh me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht pika 3, sipas së cilës ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Andaj, konsiderojmë që ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi 9

"Deklaratat tatimore vjetore jo te plota Ne DT eshte kerkuar qe te dorezohen deklaratat tatimore vjetore per 3 vitet e fundit, respektivisht per vitet 2020, 2021 dhe 2022, ndersa GOE ka dorezuar vetem deklaratat tatimore per vitet 2021 dhe 2022 ku mungon edhe viti 2020. Edhe kete kerkese ky GOE ka deshtuar ta plotesoje si edhe shume te tjera, dhe quditerisht eshte rekomanduar per kontrate."

OE i rekomanduar ka dorëzuar me ofertë Deklaratat Tatimore sipas kërkesave të DT-së vetëm për vitin 2021 dhe 2022, këto dy vite të deklaruara nuk e përmbushin kushtin e DT-së të kërkuar për qarkullimin vjetor, i cili del të jetë më i vogël se sa shuma e parashikuar prej 280.000 eurosh. Megjithatë, AK përmes nenit 72 ka pasur mundësi të kërkoj sqarime shtesë për këtë pikë, duke kërkuar nga OE i rekomanduar të dorëzoj Deklaratat edhe për një vit të paraparë, meqenëse ky dokument është lehtë i verifikueshëm se ka ekzistuar edhe para hapjes dhe sipas ekspertit nuk përbënë ndonjë ndryshim material apo pasurim të ofertës aktuale. Ky pretendim konsiderojmë që është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 10

"Kontratat e perfunduara dhe referencat gjithmone ne pjesmarrje si grup. -Shumica e kontratave dhe referencave te prezantuara nga secili anetar i ketij grupi jane kontrata ku kane qene vetem si pjesmarres ne ato kontrata te mehershme. Pra nuk kane qene ekzekutor te 100% te atyre kontratave. Pra ne si OE nuk e dime se me cfare vlere ose cfare % apo cfare peshe duhet trajtu keto kontrata te mehershme por e dime qe nuk jane 100% te anetarit pjesmarres ne kete aktivitet. -Shumica e kontratave jane te vitit 2019, dhe duke marre parasyshe piken 1

eshte e veshtire te konkludohet se sa % e kane plotesuar kete kusht GOE te rekomanduar per kontrate."

Sipas mendimit të ekspertit referencat e dorëzuara nga ana e OE i rekomanduar, sipas kriterit që operatorët duhet të kenë projekte të realizuara (të natyrës së ngjajshme) në tre vitet e fundit, minimumi në vlerë 100,000.00 euro, ku në rastin e grupit (konzorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit, janë në rregull. OE i rekomanduar ka dorëzuar referencat për anëtarët e grupit. Nga lista e kontratave dhe referencat e dorëzuara si dëshmi, udhëheqësi i grupit e përmbushë kushtin e kërkuar që së paku 51% nga 100.000 euro të kërkuara për projekte të ngjashme duhet ti takojnë këtij udhëheqësi. Sa i përket pretendimit se shumica e kontratave të realizuara nga ana e udhëheqësit të grupit janë pjesëmarrje në grup, eksperti sqaron se në DT nuk ka pasur kërkesë që udhëheqësi i grupit ofertues në këtë aktivitet duhet të arrijë shumën prej 51% të vlerës minimale me kontrata të realizuara si i vetëm dhe se nuk ka të drejtë të ketë realizuar kontrata si pjesë e konzorciumeve. Për kërkesa të cilat nuk janë pjesë e DT-së, Ak nuk mund të eleminoj dhe as të favorizoj operatorët ekonomik. Pasi që një kërkesë të tillë nuk ka pasur nga ana e AK-së, atëherë eksperti vlerëson se kjo pikë e DT-së është përmbushur dhe se ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 11

"Njeri nga antaret e OE-ve te shpallur fitues tanime eshte ne listen e zeze. Eshte per tu çuditur guximi i AK se si shpall fitues nje grup te OE-ve brenda te cilit nje antar i grupit gjendet ne listen e zeze."

Eksperti sqaron se ky aktiviet i prokurimit është iniciuar dhe hapja e ofertave është bërë në fillim të muajit qershor të vitit 2023, ndërsa anëtari i grupit në këtë konzorcium ka hyrë në listën e zezë në muajin korrik të vitit 2023, saktësisht me datë 28/07/2023. Në momentin kur anëtari i grupit është bërë pjesë e listës së zezë, procedurat e aktivitetit në fjalë kanë qenë të iniciuara. Kur është bërë aplikimi dhe hapja e ofertave, ky anëtar nuk ka qenë pjesë e listës së zezë, andaj duke marr parasysh se hapja e ofertave është bërë para dhe asnjë dispozitë e LPP-së nuk e parasheh që në çfardo faze të aktivitetit kur një anëtar i grupit bëhet pjesë e listës së zezë a duhet të diskualifikohet menjëherë apo jo, atëherë edhe eksperti në rastin aktual mund të bëjë një vlerësim duke u bazuar vetëm në gjendjen reale. Futja e një operatori ekonomik në listën e zezë, sipas ligjit përjashton pjesëmarrjen e tij në të gjitha aktivitetet e prokurimit të cilat iniciohen që nga ajo kohë, pas futjes së tij në listë të zezë me vendim. Ajo çfarë është e rëndësishme është fakti që kur OE i rekomanduar ka ofertuar dhe janë hapur ofertat ky anëtar i këtij grupi nuk ka qenë pjesë e listës së zezë. Andaj, ky pretendim konsiderojmë që është i pabazuar.

Pretendimi 12

"Mungon certifikata e ISO 9001 Lead Implementer Ne DT eshte kerkuar qe menaxheri i projektit te jete i certifikuar me ISO 9001 Lead Implementer. Certifikate te cilen GOE nuk e ka dorezuar, e ne vend te saj ka dorezuar nje deshmi qe nje person e ka kryer nje kurs nga nje organizate e cila as nuk eshte nje trupe certifikuese per te deshmuar IMPLEMENTIMIN dhe CERTIFIKIMIN me ISO standardeve, por vetem tregon se eshte ndjekur nje kurs online 4 oresh. Ne kemi bere verifikimin se a eshte UDEMY Trupe Certifikuese per kete certifikate, dhe kemi vertetuar qe kjo kompani nuk eshte ne listen e Trupave Certifikuese."

Sipas ekspertit teknik, pretendimi ankimor i OE ankues lidhet me mos plotësimin e DT dhe kërkesës që menaxheri i projektit të ketë certifikatën ISO 9001 Lead Implementer. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezentuar në ofertë, eksperti teknik thekson se OE i rekomanduar ka paraqitur menaxherin e projektit që mban një certifikatë të lëshuar nga UDEMY. Është e njohur që UDEMY nuk është trup certifikues, por një platformë e njohur për ofrimin e përmbajtjes edukative nëpërmjet kurseve dhe video-mesimeve. Certifikata nga UDEMY mund të demonstrojë njohuri në lidhje me standardin, por nuk është një akreditim formal për këtë standard. Prandaj bazuar në sqarimet e dhëna më lartë pretendimi i OE ankues kundrejt vendimit të OE të rekomanduar vlerësoj se është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **SolvIT SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi

Ernest Kërqeli